



**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - Direktorat za Kulturë, Omladinu i Sport
Department of Culture, Youth and Sport - Kültür, Gençlik ve Spor Müdürlüğü**

**KONKURS PËR SKULPTURËN MONUMENTALE TË HEROIT
KADRI ZEKA**

- *Kërkesat mbi mundësitë profesionale dhe teknike
Kapaciteti teknik dhe profesional*

Konkursit i paraprijnë kërkesat në vijim:

-Shprehja figurative në bronz dhe zgjidhja kompozicionale artistike e shtatores duhet të jetë në harmoni dhe të respektojë dimensionet e kërkuara për aplikim.

-Shtatorja si konceptim dhe si interpretim artistik duhet të jetë shprehje figurative në të cilën reflektohen qartë tiparet e heroit kombëtar Kadri Zeka;

-Figura, simbol i luftës për liri të popullit shqiptar duhet të jetë e vendosur me pamje ballore nga rruga;

-Autori fitues është i obliguar të ndërtoj edhe postamentin në raport dhe harmoni me figurën në bronz.

-Në konkurs pranohen punime individuale dhe grupe;

-Punimi nuk duhet të jetë pjesëmarrës në ndonjë konkurs tjetër apo të jetë ekspozuar në veprimtari të tjera të mëparshme të këtij lloji. Ai duhet të jetë i punuar enkas për këtë konkurs.

-Boceti i paraqitur nga konkuresit si plastikë skulpturore duhet të jetë ;

- 50 - 70 cm i lartë, pa bazamentin(postamentin);
- Realizim kreativ-artistik që korrespondon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siç janë portreti, duart, këmbët, veshja etj.
- Të prezantojë emocionalisht fizionominë dhe karakterin e figurës së Heroit Kombëtar Kadri Zeka.

- Konkuresit - Artistët kanë të drejtë që të marrin pjesë në konkurs vetëm me një punim;

- Gjatë realizimit të veprës në madhësi reale, autori fitues i konkursit, nëse e ndjen të nevojshme, mund të bëj ndryshime minore artistike por që nuk shkojnë përtej zgjidhjes së kompozicionit(bocetës) me të cilën ka fituar konkursin, duke marrë pëlqimin paraprak të komisionit.

-Shtatorja nepermjet realizimit cilësor duhet të pasurojë vlerën e sheshit dhe të evidentojë elementet që shprehin simbolikën e figurës së Heroit kombëtar Kadri Zeka;

Dokumentacioni/

- *Dëshmia e kërkuar*

-Vërejtje

Variantet të cilat nuk respektojnë specifikat e vendosura – lartësia 50 deri 70 cm, nuk do të merren parasysh, do të konsiderohen si konkurrime të cilat nuk respektojnë kriteret teknike.

Fituesi i kontratës obligohet që brenda 120 ditëve kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës, ta ndërtoj postamentin dhe ta sjellë shtatoren dhe ta vendosë në postament.

Në çmim duhet të kalkulohen të gjitha shpenzimet si: punimi i shtatores, ndërtimi i postamentit, transporti, sigurimi gjatë transportit dhe vendosja në postament dhe të gjitha tatimet e aplikueshme në Kosovë.

- *Kriteret, nën-kriteret, dhe sistemi i pikëve i cili do të përdoret për vlerësimin e Koncept Projekteve janë:*

(Elementet e poentimit të veprës artistike-BOCETËS)Pesha e vlerësimit në %

- 1) Kompozicioni artistik i shtatores
- 2) Koncepti përmbajtësor dhe mesazhet e shtatores së heroit kombëtar Kadri Zekai si luftëtar dhe patriot
- 3) Shkalla e integritetit të shtatores në hapësirën (Të prezantohen 3D pamje nga minimum 3 kënde të ndryshme)
- 4) Originaliteti artistik i modelit të shtatores

- Shtatorja do të vendoset në Qytetin e Gjilanit.
- Kompozimi i shtatores do të përfshijë pamjen figurative të shtatit të Heroit Kombëtar Kadri Zeka

Lartësia e shtatores duhet të jetë (orientuese) 300-350 cm. Materiali i fortë përfundimtar i shtatores është bronzi. Postamenti me mbishkrim duhet të jetë pjesë e ofertës së aplikuesit e cila duhet të parashihet me dimensione të përafërta si; 150-200cm lartësi, 100-150cm gjerësi dhe 100-150cm thellësi.

IV.1.1) Lloji i procedurës së vlerësimit nga Komisioni vlerësues profesional	
Nën-kriteret:(Elementet e poentimit të veprës artistike-bocetës)	Pesha në %
1) Kompozicioni artistik i shtatores (zgjedhja kompozicionale artistike e shtatores)	40
2) Koncepti përmbajtësor dhe mesazhet e shtatorës së heroit kombëtar Kadri Zeka si luftëtar dhe patriot.	25
3) Shkalla e integritit të shtatores në hapësirë (Të prezantohen 3D pamje nga minimumun 3 kënde të ndryshme)	20
4) Originaliteti artistik i modelit të shtatores	15
Gjithsejt pikë (maksimumi)	100

Aplikuesi duhet ta mbyllë projektin original në zarf të veçantë dhe në faqen e përparme të zarfit do të shënojë qartë si;

"Për Komunën e Gjilanit

"Originali – Projekti Ideor"

*Një numër anonim prej katër shifrave sipas zgjedhjes së aplikuesit
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport*

Thirrje publike për skulpturën monumentale të heroit Kadri Zeka

Të mos hapet para takimit të komisionit vlerësues"

-Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formën fizike.

-Aplikimi brenda zarfit duhet të ketë emërtimin adekuat të monumentit, të përmbajë shifrën identik me atë të punimit fizik, koston e përgjithshme të realizimit, e-mail adresën dhe numrin e telefonit, të nënshkruhet nga autori.

-Ofertën financiare duhet ta dorëzoni së bashku me aplikimin tuaj në zarf i cili duhet të përmbajë shifrën unike qartë nga aplikuesi.

-Forma e aplikimit nuk do të hapet deri në përzgjedhjen finale të punimit (bocetës) nga komisioni profesional vlerësues.

-Aplikuesi (individual ose grupor) së bashku me dokumentacionin duhet të dorëzojë edhe projektin ideor (bocetën) pranë zyreve të D.K.R.S-së

-Aplikacionet duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme: Qendra për Shërbim të Qytetarëve, Komuna e Gjilanit.

Afati i fundit për dorëzim është: 13.04.2023


Drejtori
Kushttrim Zeqiri
23.03.2023